



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagradi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61 paragrafi 61.3. lidhur me nenin 63 paragrafin 63.1.2. të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "Eurofamis" Sh.A. të datës 16.05.2025 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "141 Ndërtimi i sistemit të ujites në hapësira gjelbëruese dhe hapja e puseve" me nr. të prokurimit 616-25-3717-5-1-1, Komuna e Prishtinës (Autoriteti Kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **MIRATOHET** si pjesërisht bazuar kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Eurofamis" Sh.A. të datës 16.05.2025 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "141 Ndërtimi i sistemit të ujites në hapësira gjelbëruese dhe hapja e puseve" me nr. të prokurimit 616-25-3717-5-1-1.
- II. **DETYROHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të publikoj Formularin për Korrigimin e Gabimeve në Njoftimet e Publikuara përmes të cilit do të bëj korrigimin e kërkesave në dosjen e tenderit sipas të gjeturave të evidentuara më poshtë në këtë vendim.
- III. **NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "Eurofamis" Sh.A. (tutje "parashtruesi") me datë 16.05.2025 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "141 Ndërtimi i sistemit të ujites në hapësira gjelbëruese dhe hapja e puseve" me nr. të prokurimit 616-25-3717-5-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistonjë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in merito*) të kërkesës.

Pretendimet e parashtuesit janë cituar si në vijim:

4. Lista e mjeteve, stabilimenteve dhe pajisjeve teknike që janë të domosdoshme për realizimin e projektit ; Aneksin 10 te DT.

e) Makine per shpime gjeotermale, shpime per puse, shpime horizontale me sistem llaserik

Ky kriteri, në formën aktuale, përbën një kufizim të panevojshëm dhe joproportional të konkurrencës, dhe bie në kundërshtim me parimet themelore të prokurimit publik.

- Pas analizës së detajuar të projektit teknik dhe paramasës, konstatohet se në asnjë pozicion nuk është e paraparë kryerja e punimeve që kërkojnë përdorimin e kësaj makinerie, përkatësisht nuk janë paraparë shpime horizontale me sistem lazerik.
- Si rrjedhojë, ky kriteri nuk është në përputhje me nenin 7, paragrafi 1.6 të Ligjit të Prokurimit Publik, i cili kërkon që kriteret e përcaktuara të janë proporcionale dhe të lidhura drejtpërdrejt me natyrën dhe kompleksitetin e kontratës.
- Si rrjedhojë, ky kriteri nuk është në përputhje me nenin 7, paragrafi 1.6 të Ligjit të Prokurimit Publik, i cili kërkon që kriteret e përeaktuara të janë proporcionale dhe të lidhura drejtpërdrejt me natyrën dhe kompleksitetin e kontratës.
- Nëse në ndonjë pjesë të zbatimit lind nevoja për përdorimin e kësaj metode, ajo mund të sigurohet përmes nënkontraktimit apo marrëveshjes me palë të treta, pa e bërë kusht posdimin fizik të makinerisë në momentin e aplikimit.

5. Autorizimi dhe katalogu per pozicionet 3.0, 8.0, 14.0, 15.0, 23.0, 24.0, 25.0, 42.0, 43.0, 44.0, 45.0, 46.0, 47.0, 55.0, 56.0, 57.0,

- Produktet e përfshira në këto pozicione (si gypa, pompa, valvola, panele, etj.) janë produkte standarde të tregut, dhe nuk përfshijnë pajisje me karakter të tillë që të kërkojnë certifikim të detyrueshëm për ofertim.
- Kjo kërkesë në këtë fazë krijon pengesë të panevojshme për pjesëmarrje dhe përjashton operatorë që përbushin të gjitha kushtet esenciale të projektit.
- Sipas praktikës dhe logjikës së prokurimit, dokumente të tilla mund të kerkohen nga operatori fitues në fazën e nënshkrimit të kontratës, dhe nuk është e domosdoshme të dorëzohen gjatë ofertimit – përvçë nëse kanë të bëjnë me ndonjë certifikim të obliguar në projekt, gjë që në këtë rast nuk qëndron.

Kërkojmë nga autoriteti kontrakues që:

Të largohet kërkesa për paraqitjen e katalogëve dhe autorizimeve në fazën e ofertimit, për pozicionet e sipërpërmendura, ose së paku, të lejohet që këto dokumente të dorëzohen vetëm nga operatori fitues në fazën e kontraktimit.

6. Garancioni per pozicionet 3.0, 8.0, 14.0, 15.0, 23.0, 24.0, 25.0, 42.0, 43.0, 44.0, 45.0, 46.0, 47.0, 55.0, 56.0, 57.0, minimum 2 vite.

- Një pjesë e këtyre pozicioneve përfshijnë materiale harxhuese ose për përdorim të zakonshëm, si gypa PVC, PE, elemente ndërlidhëse etj., të cilat zakonisht nuk ofrohen me garanci të prodhuesit për 2 vite, për shkak të natyrës së përdorimit ose ndikimeve të kushteve të instalimit dhe mijedisit.
- Prodhucesit vendorë dhe ndërkombëtarë zakonisht jepin garanci për pompë, valvola apo panele, por jo për të gjitha materialet përfshirë në këto pozicione, dhe si të tilla, detyrimi për garanci 2-vjeçare për çdo pozicion është joproportional.
- Ligji për Prokurim Publik (neni 7, pika 1.6) përcakton se kriteret duhet të janë të nevojshme, të përshtatshme dhe proporcionale me natyrën e kontratës.
- Nëse autoriteti kontraktues e shëh të nevojshme garancionin për produkte specifike, kjo mund të specifikohet vetëm për ato pozita – dhe jo në mënyrë gjenerale për të gjitha materialet.

Kërkesa për garacion 2-vjeçar të rishikohet dhe të specifikohet vetëm për pajisjet që teknikisht dhe praktikisht mbulohen nga garancia e prodhuesit, si pompat, valvolat etj.,

Faqe 2 nga 3

Adresa: Rr. "UÇK" nr. 2, Prishtinë 10000

Tel.: 038-200-40-111

Email: visar.shehu@rks-gov.net

Lidhur me pretendimet ankimore të parashtruesit, është gjetur se pretendimet janë pjesërisht të bazuara dhe në bashkëpunim me njësinë kërkuese duhet të rivlerësohet nëse kërkesat e DT janë të domosdoshme për të realizuar projektin në mënyrë efikase dhe efektive.


Vlen të citohet nenı 7 paragrafi 2 të LPP përmes të cilit përcaktohet se "Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë te një ose më shume operatoreve ekonomik".

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pjesërisht pretendimet e tij ankimore. Prandaj kërkesa e tij për rishqyrtim është miratuar si e bazuar pjesërisht.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.1.2. të RRPP. Për pikën III dhe pikën IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënët më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 10.06.2025



Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtyues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.